

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.02.2023*

15.02.2023
Ora 11:11

RENDI I DITËS

Projektakti “Për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së Komisioneve të Qendrave të Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë: KRIIK, Z. G. Dashi (B/Berat)**

Z.I.Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëhere, në seancën e sotme publike kemi për shqyrtim në rend të ditës dy çështje: Projektvendimi për miratimin e modeleve të vendimeve dhe dokumentacionit të punës së Komisionit të Qendrës së Votimit. Pika e dytë ka të bëjë me vlerësimin e raportit mbi monitorimin e veprimtarisë së institucioneve publike për periudhën 3 Shkurt - 9 Shkurt 2023. Çështje të tjera në rend dite nuk kemi, këto janë. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përmbushje të kompetencës së parashikuar nga Kodi Zgjedhor, për drejtimin dhe mbikqyrjen e veprimtarisë së administratës zgjedhore, përcakton modelet e vendimeve dhe të dokumentacionit të punës që do të përdorin Komisionet e Qendrave të Votimit që do të ngrihen për

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.02.2023*

zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023. Projektvendimi përcakton modelet e vendimeve dhe të dokumentacionit të punës që Komisioni Qendres së Votimit (KQV), kryen në përmbushje të detyrimeve për administrimin e procesit të votimit në Qendrën e Votimit. Këto modele vendimesh dhe dokumentacioni i punës janë konfiguruar nga KQZ për t'u ardhur në ndihmë Komisioneve të Qendrave të Votimit duke synuar lehtësimin e punës së tyre. Ky projektvendim përfshin modele të vendimeve të KQV që lidhen me funksionimin e saj. Modelet e vendimeve janë:

Për caktimin e detyrave të anëtarëve të KQV;

Për hapjen e votimit;

Për largimin e personave të caktuar nga mjediset e Qendrës së Votimit;

Për pezullimin e votimit;

Për kërkimin e ndihmës nga policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në Qendrën e Votimit;

Për largimin nga Qendra e Votimit të forcave të policisë së shtetit;

Për mbylljen e votimit.

Gjithashtu kemi parashikuar edhe dokumentacionin për modelin e punës siç është edhe librin e protokollit të Komisionit të Qendrës së Votimit si dhe regjistrin e posaçëm të zgjedhëzve. Gjithashtu në këtë vendim kemi përcaktuar edhe procesverbalet që do të përdor Komisioni i Qendrës së Votimit siç janë:

Procesverbal i pezullimit të votimit;

Procesverbal i rifillimit të votimit në Qendrën e Votimit;

Procesverbal i mbylljes së Qendrës së Votimit.

Modelet e vendimeve dhe dokumentacioni i punës së KQV kodifikohen sipas kategorive të tyre nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin dhe miratim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.02.2023*

Z. I. Celibashi: Ja kemi përcjellë partive politike për njohje dhe për konsultim?
Dakord! Atëhere, e miratojmë projektvendimin sipas draftit të propozuar.

Vendimi nr. 56

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.02.2023*

**15.02.2023
Ora 11:13**

RENDI I DITËS

Vijimi i hetimit administrativ për shkelje të konstatuara për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, qendrore dhe vendore si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, për periudhën 3 shkurt – 9 shkurt 2023.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta**
- **Parti Politike:**
- **Të tjerë: KRIIK, Z. G. Dashi (B/Berat)**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës. Tek vlerësimi i raportit mbi veprimtarinë e institucioneve publike për periudhën 3 Shkurt-9 Shkurt.

Znj. M. Koja: Komisioner, pikë se pari bëjmë një panoramë të përgjithshme nga data 13 Janar deri më sot. Në total janë raportuar 838 veprimtari nga 74 institucione. Ndërsa për sa i përket periudhës së monitorimit 3 Shkurt deri me datë 9 Shkurt në total janë raportuar 225 veprimtari nga 47 institucione. Nga këto 225 veprimtari 40 konstatohen në shkelje të afatit ligjor. Këto 40 veprimtari janë raportuar nga 19 institucione. Ndërkohë kemi marrë feedback dhe shpjegime nga një pjesë e konsiderueshme e institucioneve 11 prej tyre. Sot kanë ardhur

**Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.02.2023*

shkresërisht disa të tjera jemi në fazën e vlerësimit dhe deri më tani konstatojmë që ka shkelje të afatit jo për mungesë vullneti për disa që kanë dhënë shpjegime por për shkak të riraportimit. Pra, i është shtyrë veprimtaria dhe është riraportuar por janë në përmbushje të afatit ligjor. Pra, njoftimi në KQZ dhe mundësia e KQZ-së për vlerësim është dhënë e plotë në afatin ligjor të përcaktuar. Gjithashtu dua të sjellë në vëmendje që Koalicioni për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) krahas raportimeve për respektim të afatit nga institucionet ka sjellë në vëmendje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve disa raste të konstatuara nga ana e tyre, veprimtari të zhvilluara por të pa raportuara në faqen e dedikuar për këtë qëllim në KQZ. Konkretisht për periudhën 20-23 Janar janë dy raste denoncimesh për të cilat ne kemi filluar hetimin administrativ dhe jemi në fazë të shqyrtimit të pretendimeve. Për periudhën 20 Janar- 2 Shkurt që përkon me periudhën e monitorimeve nga KQZ nuk ka pasur denoncime, ndërsa për periudhën që shqyrtojmë sot 3 Shkurt- 9 Shkurt janë 17 raste denoncimesh për veprimtari publike të zhvilluara nga Bashkitë Përrenjas, Përmet, Kukës, Patos, Dibër dhe AKU dhe të pa raportuara në KQZ edhe për këto kemi filluar procedurën e hetimit administrativ dhe jemi në fazën e shqyrtimit. Faleminderit! Ndërkohë duhet të dimë nëse ka institucione që janë sot prezent për të dhënë shpjegimet e tyre.

Z. I. Celibashi: Atëhere, janë 19 institucione të cilat janë përfshirë në këtë raport.

Znj. M. Koja: Po, 19 institucione.

Z. G. Dashi përfaqësues i Bashkisë Berat: Përshëndetje të gjithëve! Unë jam Gentian Dashi përfaqësues i Bashkisë Berat. Jam personi përgjegjës për raportimet

Zbardhi materialin audio

Ardita CAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.02.2023*

e aktiviteteve të Bashkisë Berat. Nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve na ka ardhur një email ku na njofton në lidhje me një pa rregullësi për një njoftim që ne kemi paraqitur në datën 6 Shkurt të vitit 2023, për një aktivitet po themi në thonjëza sepse ka qenë një vijueshmëri e punës rutinë të Bashkisë Berat. Për një inspektim të punimeve që zhvillohen në Shkollën Babdudë Karbunara që është në një distancë shumë të afërt me bashkinë. Gjithësesi ne duke qenë se ky inspektim është planifikuar në datën 5.02 që ka qenë ditë e Diel, në pamundësi për të raportuar sepse nuk ka qenë një ditë pune zyrtare e kemi raportua ditën e Hënë. Gjithësesi ne themi e raportojmë se nuk është zhvilluar si inspektim pasi për këtë pa rregullsi që do të ndodhte në qoftë se do të zhvillohej në datë 10.02. Nuk është pasqyruar në asnjë media, në asnjë faqe zyrtare dhe nuk është zhvilluar realisht si inspektim.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Bëhet fjalë për një rast shkelje nga 9 raportime vetëm ky është rasti zonja Koja?

Znj. M. Koja: Po, ky është rasti.

Z. I. Celibashi: Dakord! Gjithësesi për dijeninë tuaj nuk ka asnjë lloj ndalimi për të zhvilluar veprimtari të këtij karakteri nga ana e Kryetarit të Bashkisë, që lidhet me përmbushjen e funksioneve të tij. Ajo çfarë ju detyron ligji, është që në çdo rast ju do të duhet ta raportoni minimalisht 5 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit. Sipas ligjit janë të ndaluara të gjithë ato aktivitete të cilat janë me qëllime elektorale po duke përdorur resurset publike. Mirë faleminderit! Përfaqësues të institucioneve të tjera nuk kemi, prezent?! Dakord, do të bëjmë një vlerësim të pretendimeve dhe të parashtrimeve të gjitha institucioneve pra të 19

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.02.2023

institucioneve dhe ditën e Premte do të disponojmë me vendimarrje. Para se të përfundojë duke vlerësuar edhe angazhimin realisht të disa organizatave të shoqërisë civile, me qëllim që të jemi eficient në administrimin e procesit administrativ më së pari të kohës, ju lutem bëjani atyre me dije periudhën e monitorimit, të cilën KQZ e bën si të thuash ditët në të cilën ne monitorojmë nga e Entja deri të Premten e javës tjetër.

Znj. M. Koja: Atëhere, ne monitorojmë nga dita e Premte deri të Enjten dhe të Premten dalim në konkluzione dhe njoftojmë institucionet për shkeljet e konstatuara. U japim kohë deri në ditën e Mërkurë që ti paraqesin pretendimet ose bien email siç kemi rënë dakord me ta, ose të paraqiten në seancë për ti dhënë ato fizikisht këtu.

Z. I. Celibashi: Bëjani këtë njoftim me shkrim të gjitha organizatave që të përputhin periudhën e monitorimit me periudhën e monitorimit të KQZ-së. Mirë dakord, e mbyllim edhe këtë pikë të rendit të ditës. Çështje të tjera në rend të ditës nuk kemi. Faleminderit seanca mbyllet!

Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI

